REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 310/17
Datë/Datum. 04.09.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Shëndetësisë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-17-3120-1-1-1**

Numri i brendshëm: **206-17-028-111**

Lotet:
5,6,7,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,32,34,35,36,37,143,144,145,146,147,148,149,150,151,155.

Sa i përket tenderit për "**Furnizim me material shpenzues medicional nga Lista Esenciale**"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Liri-Med sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Agim Ramadani nr.80
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 [redacted]
(Numri Telefonit)

038 512 902
(Numri i Faks-it)

Lirim Mustafa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]
(Adresa elektronike)

04.09.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

S.H.P.K. "Liri-Med" Prishtinë

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

- *Vendimi i AK mbi refuzimin e Ankesës , te pranuar me datë: 30.08.2017- permes emailit.*
- *Parqitja e ankesës në OSHP me datë : 04.09.2017.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Ne përputhje me nenin 108A te LPP-se, Operatori ekonomik Liri-Med ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim , e cila kërkesë është refuzuar duke mos shqyrtuar asnje prej pretendimeve ankimore të OE Liri-Med.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Supozojmë se Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-17-3120-1-1-1,** Numri i brendshëm: **206-17-028-111, Lotet: 5,6,7,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,32,34,35,36,37,143,144,145,146,147,148,149,150,151,155.**

Titulli i tenderit "**Furnizim me material shpenzues medicional nga Lista Esenciale" nuk ka rrespektuar dizpozitat e LPP-se , si në vijim:**

Nenin 59 – Ekzaminimi , Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve sepse është shpërblyer me kontratë OE "Agani LTD" , e cila është në kundërshtim me pikën 7 të FDT-se dhe është eliminuar OE Liri-Med , e cila ka ofertuar në harmoni me të gjitha kërkesat sipas FDT-se.

Nenin 69 – Aftësia teknike dhe / ose profesionale në lidhje me pikën 6 dhe 7 te FDT- poashtu është eliminuar OE Liri-Med me pretendim se nuk ka plotësuar kerkesen 7 te FDT-se pa u shqyrtuar fare dokumentacioni i dorëzuar dhe është rekomanduar me dhënie të kontratës OE Agani LTD , i cili ka ofertuar në kundërshtim me kërkesën 7 të FDT-se.

Nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo – Diskriminimi; supozojmë se OE Liri-Med është diskriminuar gjatë procesit të vlerësimit të këtij Aktiviteti të prokurimit sepse është eliminuar padrejtësishtë dhe kjo paraqet jo barazi gjatë trajtimit të kësaj procedure, duke rekomanduar për kontratë kompaninë , e cila ka ofertuar në kundërshtim me pikën 7 te FDT-se.

Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti – për pjesët 143, 144, 145 , është rekomanduar për dhënie të kontratës OE Agani , me çmim perreth 14,000.00 euro më të lartë se OE Liri-Med, për shkak se nuk janë marë përbazë të gjitha shifrat e ofertës pas presjes dhjetore , me ç'rast supozojmë se është dëmtuar Buxheti i Republikës së Kosovës në mënyrë të qëllimshme , duke kufizuar se çmimet e ofertës janë të pranueshme vetëm me dy shifra pas presjes dhjetore dhe në këtë mënyrë është dëmtuar Buxheti i Republikës së Kosovës ne vlerë prej perreth 14,000.00 eurove.

Neni 72. Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë – nuk është kërkuar asnjë informacion apo dokumentacion shtesë nga Autoriteti Kontraktues , edhe nëse ka pasur paqartësi apo informacion të mangët, AK ka eliminuar OE Liri-Med pa kerkuar asnje informacion shtese .

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Supozojmë se nuk jane rrespektuar Ligjet ne Fuqi te LPP-se gjegjesisht nenent e lartëshkruara.

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk është rrespektuar Neni 59 i LPP-se duke pasur parasysh se ne Letren standarde per tenderuesin e eliminuar qe kemi pranuar me date 22.08.2017 , sipas Autoritetit Kontraktues Kompania Liri-Med: ka pasur gabime